


1




PËRKUFIZIMI I NOCIONIT FËMIJË

2



MOSDISKRIMINI

3



INTERESI MË I MIRË I FËMIJËS

4



REALIZIMI I TË DREJTAVE

5



UDHËZIMET E FAMILJES GJATË ZHVILLIMIT TË FËMIJËS

6




JETA, MBIJETESA DHE ZHVILLIMI

7



EMRI DHE NËNSHTETËSIA

8



IDENTITETI

9



RUAJTJA E UNITETIT FAMILJAR

10



E DREJTA PËR T'I KONTAKTUAR PRINDËRIT QË JANË JASHTË SHTETIT

11



MBROJTJA NGA KIDNAPIMI

12



RESPEKTIMI I KËNDVËSHTRIMIT TË FËMIJËS

13



SHPREHJA E LIRË

14



LIRIA E MENDIMIT DHE E RELIGJIONIT

15



SHOQËRIMI DHE QASJA NË GRUPE DHE ORGANIZATA

16



E DREJTA E PRIVATËSISË

17



QASJA NË INFORMACIONE

18




PËRGJEGJËSIA E PRINDËRVE

19




MBROJTJA NGA DHUNA

20



IJËT PA KUJDES PRINDËROR

21



ADOPTIMI

22



FËMIJËT REFUGJATË

23



FËMIJËT ME PAAFTËSI

24



SHËNDETI, USHQIMI, UJI DHE MJEDISI

25



KONTROLLIMI I AKOMODIMIT TË FËMIJËS

26



NDIHMA SOCIALE DHE EKONOMIKE

27



USHQIMI, VESHMBATHJA DHE SIGURIA

28




QASJA NË ARSIM

29



QËLLIMET E ARSIMIT

30



KULTURA, GJUHA DHE FEJA E PAKICAVE

31




PUSHIMI, LOJA, KULTURA DHE ARTI

32



MBROJTJE NGA PUNA E RREZIKSHME

33



MBROJTJA NGA DROGAT E REZIKSHME

34



MBROJTJE NGA ABUZIMI SEKSUAL

35



MBROJTJA KUNDËR SHITJES DHE TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE

36



MBROJTJA NGA EKSPLOATIMI

37



FËMIJË TË PRIVUAR NGA LIRIA

38



MBROJTJA NË KOHË LUFTE

39




RIKUPERIMI DHE RIINTEGRIMI

40



FËMIJË QË E KANË SHKELË LIGJIN

41




ZBATIMI I LIGJEVE MË TË MIRA

42



TË GJITHË DUHET T'I DINË TË DREJTAT E FËMIJËVE

43-54



SI ZBATOHET KONVENTA

KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE

Fëmija është çdo person nën moshën 18 vjeçare.	Të gjithë fëmijët i gëzojnë të gjitha të drejtat, pavarësisht se kush janë, ku jetojnë, çfarë gjuhe flasin, cilës fe i përkasin, çfarë mendojnë, si duken, a janë meshkuj apo femra, nëse janë me paaftësi, nëse janë të pasur ose të varfër dhe pavarësisht se cilët janë prindërit dhe familja e tyre, ose çfarë besojnë dhe bëjnë prindërit dhe familja e tyre. Asnjë fëmijë nuk duhet të trajtohet në mënyrë të padrejtë për asnjë arsye.	Kur marrin vendime të rriturit, ata duhet ta marrin parasysh se si do të ndikojnë këto vendime te fëmijët. Të gjithë të rriturit duhet të bëjnë atë që është më e mira për fëmijët. Shtetet duhet të mundësojnë që fëmijët të mbrohen, ndërsa prindërit, ose njerëzit e tjerë kur është e nevojshme, të kujdesen mirë për ta. Shtetet duhet të mundësojnë që njerëzit dhe vendet përgjegjëse për kujdesin ndaj fëmijëve ta bëjnë mirë punën e tyre.	Shtetet duhet të bëjnë gjithçka që kanë në fuqinë e tyre për t’iu mundësuar të gjithë fëmijëve në vendet e tyre t’i gëzojë të gjitha të drejtat.	Shtetet duhet t’ua lënë familjeve dhe bashkësive t’i orientojnë fëmijët, ashtu që gjatë rritjes fëmijët të mësojnë t’i shfrytëzojnë të drejtat e tyre në mënyrën më të mirë. Ashtu siç rriten ndër vite, fëmijët do të kenë nevojë për më pak udhëzime.	Secili fëmijë e gëzon të drejtën e jetës. Shtetet duhet t’u mundësojnë fëmijëve të mbijetojnë dhe të zhvillohen në mënyrën më të mirë të mundshme.	Fëmijët duhet të regjistrohen menjëherë pas lindjes dhe t’u jepet një emër i njohur zyrtarisht nga shteti. Fëmijët duhet të kenë shtetësi (t’i përkasin një shteti). Gjithnjë kur është e mundur, fëmijët duhet t’i njohin prindërit e tyre, ndërsa prindërit duhet të kujdesen për ta.
Fëmijët e gëzojnë të drejtën e identitetit të tyre – një regjistrim zyrtar për atë se kush janë ata, ku përfshihet emri, shtetësia dhe marrëdhëniet familjare. Askush nuk duhet t’ua heqë këtë të drejtë, mirëpo nëse ndodh diçka e tillë, shteti duhet t’i ndihmojë fëmijët që shpejt ta rikthejnë identitetin e tyre.	Fëmijët nuk duhet të ndahen nga prindërit e tyre, përveç nëse nuk e marrin kujdesin e duhur prej tyre – për shembull, nëse prindi e lëndon fëmijën ose e neglizhon atë. Fëmijët, prindërit e të cilëve nuk jetojnë së bashku me ta, duhet të mbajnë kontakte me të dy prindërit, përveç kur një gjë e tillë i dëmton fëmijët.	Nëse fëmija dhe prindërit jetojnë në vende të ndryshme, shtetet duhet t’i lejojnë fëmijët dhe prindërit të lëvizin midis atyre vendeve për të ngelë në kontakt dhe për të qenë së bashku si familje.	Shtetet duhet ta parandalojnë nxjerrjen e fëmijëve jashtë vendit të tyre nëse një veprim i tillë është kundër ligjit – për shembull, kidnapimi nga dikush ose mbajtja jashtë vendit nga njëri prind, kur prindi tjetër nuk është dakord.	Fëmijët kanë të drejtë ta shprehin lirshëm mendimin e tyre për çështjet që i shqetësojnë ata. Të rriturit duhet t’i dëgjojnë dhe ta marrin seriozisht mendimin e tyre.	Fëmijët kanë të drejtë ta ndajnë lirisht me të tjerët atë që e mësojnë, mendojnë ose ndjejnë, nëpërmjet të folurit, vizatimit, shkrimit ose në ndonjë mënyrë tjetër, përveçse në ndonjë mënyrë që mund t’i dëmtojë njerëzit e tjerë.	Fëmijët e gëzojnë të drejtën e mendimit të tyre dhe të drejtën për ta praktikuar fenë e tyre, përderisa kjo nuk i pengon njerëzit e tjerë t’i gëzojnë të drejtat e tyre. Prindërit duhet t’i orientojnë fëmijët e tyre në mënyrë që ata të mësojnë ta ushtrojnë siç duhet këtë të drejtë, kur të rriten.
Fëmijët kanë të drejtë të takohen dhe të kenë qasje në grupe dhe organizata për aq kohë sa kjo nuk i pengon njerëzit e tjerë t’i gëzojnë të drejtat e tyre.	Secili fëmijë e gëzon të drejtën e privatësisë. Ligji duhet ta mbrojë privatësinë e fëmijëve, familjes së tyre, shtëpisë, gjegjësisht ta mbrojë nga çdo lloj sulmi komunikimin dhe reputacionin e mirë e tyre.	Fëmijët kanë të drejtë të marrin informacione nga interneti, radioja, televizioni, revista, libra dhe burimet tjera. Të rriturit duhet të kenë kujdes që informacioni të mos i dëmtojë fëmijët. Shtetet duhet t’i inkurajojnë mediat që të ndajnë një shumëllojshmëri informacionesh në një gjuhë, të cilën të gjithë fëmijët mund ta kuptojnë.	Të dy prindërit e ndajnë përgjegjësinë për edukimin e fëmijëve e tyre. Kur një fëmijë nuk ka prindër, një person tjetër i rritur e merr përgjegjësinë dhe quhet “kujdestar”. Prindërit dhe kujdestarët duhet të bëjnë gjithmonë atë që është më e mira për fëmijën. Shteti duhet t’i ndihmojë ata duke ofruar shërbime dhe mbështetje për prindërit dhe kujdestarët.	Shteti duhet t’i mbrojë fëmijët nga dhuna, abuzimi dhe neglizhenca nga prindërit ose kushdo që kujdeset për ta.	Fëmijët për të cilët prindërit dhe familja nuk mund të kujdesen në mënyrë adekuate, kanë të drejtë të merren nën kujdesin e njerëzve, të cilët e respektojnë fenë, kulturën, gjuhën dhe aspekte tjera të jetës së tyre.	Kur fëmijët adoptohen (birësohen), duhet t’i jepet përparësi interesit të tyre më të mirë. Nëse një fëmijë pa prindër nuk mund të kujdeset siç duhet në vendin e tij, atëherë ai mund të adoptohet në një vend tjetër.
Fëmijët, të cilët largohen nga vendi i tyre - sepse nuk janë të sigurt atje - dhe shkojnë në një vend tjetër, duhet t’i gëzojnë të njëjtat të drejta si fëmijët e lindur në atë vend.	Secili fëmijë me paaftësi duhet ta ketë jetën më të mirë të mundshme në shoqëri. Shteti duhet t’i mënjanojë të gjitha barrierat për t’u mundësuar fëmijëve me paaftësi të bëhen të pavarur dhe të marrin pjesë aktive në bashkësi.	Fëmijët e gëzojnë të drejtën për kujdesin më të mirë shëndetësor, për ujë të pijshëm të pastër, ushqim të shëndetshëm dhe mjedis të pastër e të sigurt. Të gjithë të rriturit dhe të gjithë fëmijët duhet të kenë informacione se si ta ruajnë shëndetin e tyre dhe të ngelin të sigurtë.	Gjendja e fëmijëve që janë vendosur jashtë shtëpisë – për shkak të kujdesit, mbrojtjes apo kujdesit shëndetësor të tyre – duhet të kontrollohet rregullisht, për ta parë nëse gjithçka është në rregull dhe nëse akomodimi përkatës është zgjedhja më e mirë për fëmijën.	Shteti duhet të sigurojë burime plotësuese financiare dhe ndihma tjera për fëmijët, të cilët jetojnë në familje të varfra.	Fëmijët kanë të drejtën për ushqim, veshmbathje dhe vend të sigurt për të jetuar, në mënyrë që ata të mund të zhvillohen në mënyrën më të mirë të mundshme. Shteti duhet t’i ndihmojë familjet dhe fëmijët, që nuk mund ta përballojnë këtë ngarkesë.	Secili fëmijë ka të drejtë për arsimim. Arsimi fillor duhet të jetë falas. Arsimi i mesëm dhe ai sipëror duhet të jenë të qasshëm për çdo fëmijë. Fëmijët duhet të inkurajohen ta ndjekin mësimin deri në nivelin më të lartë të mundshëm. Disiplina në shkolla duhet t’i respektojë të drejtat e fëmijëve, pra të mos përdoret asnjëherë disiplinim i dhunshëm.
Arsimi duhet t’i ndihmojë fëmijët ta zhvillojnë plotësisht karakterin, talentin dhe aftësitë e tyre. Ai duhet t’i mësojë ata t’i kuptojnë të drejtat e tyre dhe t’i respektojnë të drejtat, kulturën dhe identitetin e njerëzve të tjerë. Gjithashtu duhet t’i ndihmojë ata të jetojnë në paqe dhe ta mbrojnë mjedisin.	Fëmijët kanë të drejtë ta përdorin gjuhën e tyre amtare, kulturën dhe fenë – edhe nëse shumica e njerëzve në vendin ku jetojnë nuk janë pjesë e asaj kulture ose feje.	Secili fëmijë ka të drejtë të pushojë dhe të luajë, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në aktivitete kulturore dhe kreative.	Fëmijët kanë të drejtë të mbrohen nga puna që është e rrezikshme ose që mund ta dëmtojë edukimin, shëndetin dhe zhvillimin e tyre. Nëse fëmijët punojnë, ata kanë të drejtë për punë të sigurt dhe pagesë të drejtë për punën e tyre.	Shteti duhet t’i mbrojë fëmijët nga përdorimi i drogës, si dhe nga përfshirja në prodhimin, transportin dhe shitjen e saj.	Shteti duhet t’i mbrojë fëmijët nga eksploatimi (shfrytëzimi) dhe abuzimi seksual, duke përfshirë mbrojtjen nga njerëzit që i detyrojnë fëmijët të bëjnë seks për para ose të marrin pjesë në fotografi dhe filma me përmbajtje seksuale.	Shtetet duhet ta parandalojnë kidnapimin dhe shitjen e fëmijëve ose dërgimin e tyre në një shtet ose vend tjetër për eksploatim dhe shfrytëzim.
Fëmijët e gëzojnë të drejtën e mbrojtjes nga të gjitha llojet e eksploatimit (shfrytëzimit), edhe kur ato lloje të eksploatimit nuk përmenden në Konventë.	Fëmijët, të cilët akuzohen për shkelje të ligjit nuk duhet të vriten, t’i nënshtrohen torturave, trajtimeve mizore dhe të burgosen përgjithmonë. Burgu duhet të jetë zgjedhja e fundit e mundshme dhe për kohën më të shkurtër të mundshme. Fëmijët e privuar nga liria duhet të kenë ndihmë ligjore dhe të lejojen të mbajnë kontakte me familjet e tyre.	Fëmijët kanë të drejtë të mbrohen gjatë luftës. Asnjë fëmijë nën moshën 15 vjeç nuk mund të bashkohet me ushtrinë dhe të marrë pjesë në luftë.	Fëmijët, të cilët janë lënduar, janë lënë pas dore, keqtrajtuar ose janë viktima të konfliktit ushtarak kanë të drejtë të marrin ndihmë për ta rikuperuar shëndetin dhe dinjitetin e tyre.	Fëmijët e akuzuar për shkelje të ligjit e gëzojnë të drejtën e ndihmës juridike dhe trajtimit të drejtë. Duhet të ketë shumë zgjidhje për t’i ndihmuar ata fëmijë të bëhen anëtarë të mirë të komuniteteve të tyre. Burgu duhet të jetë zgjidhja e fundit e mundshme.	Nëse ligjet e një vendi i mbrojnë të drejtat e fëmijëve më mirë se Konventa, atëherë duhet të zbatohen ato ligje.	Shtetet duhet t’i njohin fëmijët dhe të rriturit me përmbajtjen e kësaj Konvente në mënyrë që të gjithë të t’i njohin të drejtat e fëmijëve.

Në këta nene qartësohet se çka bëjnë shtetet, Kombet e Bashkuara – përfshirë Komitetin e UNICEF-it për të Drejtat e Fëmijëve – dhe organizatat tjera për të mundësuar që çdo fëmijë t’i gëzojë të gjitha të drejtat e tij.



KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE

KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE – VERSIONI PËR FËMIJËT

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve është një marrëveshje historike midis vendeve të ndryshme, të cilat janë zotuar t’i mbrojnë të drejtat e fëmijëve.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve shpjegon se kush janë fëmijët, cilat janë të drejtat e tyre dhe cilat janë përgjegjësitë e vendeve nënshkruese. Të gjitha të drejtat janë të ndërlidhura, njëlloj të rëndësishme dhe nuk mund t’u merren fëmijëve.

Ky tekst është hartuar me mbështetjen e Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve.



child rights connect



for every child